

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P. Nr. 141/01

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, trupi gjykues i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Ingo Risch si Kryetari trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Gunnar Oyhaugen dhe Gjyqtarja e Kosovës Lumturije Muhaxheri si anëtarë të trupit gjykues, me asistimin e Proceimbajtëses Robina Struthers, në lëndën penale kundër të akuzuarit:

AGIM SYLEJMANI, emri i babës Amrush dhe nënës Gjulunaze, e lindur Kozniku, i lindur me 19 Janar 1948 në Pernoc, Rahovec, banor i Gjakovës, nr. 16, rruga “Ibrahim Fehmiu”, i martuar dhe baba i katër fëmijëve (tre të gjallë), Shqiptari i Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, auto-elektricitist, ka kryer shërbimin ushtarak të detyrueshëm në vitin 1970 në Pozharevc, i gjendjes së varfër ekonomike, nuk dihen dënime të mëhershme.

Akuzohet sipas Aktakuzës PP. Nr.111/00, të datës 23 Nëntor 2000, për veprën penale si në vijim:

Vrasje në kundërshtim me Nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK):

Sipas së cilës ai, me datë 27 Qershor 2000, rreth orës 1700, në rrugën “Ibrahim Fehmiu” në Gjakovë, me dashje i mori jetën Berat Mushoviqit, nga Gjakova, së bashku me të birin e tij Ilirin, pas disa mosmarrëveshjeve që kishin ndodhurën mes tyre si fqinjë, në atë mënyrë që në ditën kritike pas një fjalosje verbale me viktimën, ai hyri në shtëpinë e tij së bashku me të birin e tij dhe u armatos me armë automatike AK-47, pastaj ata që të dy shkuan në shtëpinë e viktimës dhe gjersa viktimja hapi derën, ata të dy shkrepën disa herë armën mbi të kështu e qëlluan atë në anën e djathtë të kokës nga prapa, dhe më tej i

shkaktuan edhe dy plagë në gjurin e majtë, si pasojë e të cilave viktima humbi jetën menjëherë në atë çast.

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 10 dhe 11 Janar 2011, në prani të:

- Të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës Ztr Teki Boshi;
- Prokurorit Publik të EULEX-it, Ztr. Peter KORNECK;

Trupi gjykues, pas vendimmarrjes dhe votimit me datë 11 Janar 2011 dhe në përputhshmëri me Nenin 350 të Ligjit mbi Procedurat Penale 1986 (LPP), shpall publikisht dhe në prani të të akuzuarit, përfaqësuesit të tij ligjor dhe Prokurorit Publik se:

AGIM SYLEJMANI

LIROHET

Se ka kryer veprën penale të Vrasjes, në kundërshtim me Nenin 30 (l) të Ligjit Penal të Kosovës, e kryer në Gjakovë me datë 27 Qershor 2000, sepse nuk është dëshmuar se i pandehuri ka kryer veprën për të cilën ngarkohet.

Sipas Nenit 99 par 1 LPP-së, shpenzimet e procedurës si dhe shpenzimet e domosdoshme të të akuzuarit do të mbulohen nga buxheti i gjykatës.

ARSYETIM

A. PRAPAVIJA PROCEDURALE

Me datë 23 Nëntor 2000 Prokurori i Qarkut parashtroi aktakuzën PP nr 111/00 kundër Agim Sylejmanit duke e akuzuar atë për vrasje në kundërshtim me Nenin 30 paragrafi 1 të LPK-së. Kështu pas këtij shqyrtimit kryesor me datë 26 Mars 2001 trupi gjykues liroi Agim Sylejmani nga akuza e aktakuzës.

Prokurori Publik i Qarkut parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme. Pas seancës së mbajtur me datë 13 Shtator 2001 gjykata lëshoi vendimin Ap. No. 166/2001. Në këtë vendim Gjykata Supreme mbështeti ankesën e prokurorit dhe ktheu lëndën në instancën e parë për ri-gjykim.

Më pas pati tentime për të mbajtur rigjykimin në Pejë me datë 17 Nëntor 2004. Këto përpjekje shkuan huq për shkak të vështirësive për të siguruar pjesëmarrjen e dëshmitarëve Mushoviq, të cilët në atë kohë jetonin në Mal të Zi.

Me datë 21 Janar 2010 në bazë të kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Asambleja e Gjyqtareve të EULEX-it lëshoi vendimin se Gjyqtaret e EULEX-it do ta marrin këtë lëndë.

Në bazë të kërkesës së Kryetarit të Trupit Gjykues Ingo Risch. Ministria e Drejtësisë lëshoi kërkesë për ndihmë ndërkombëtare juridike në Mal të Zi për të gjetur dhe dërguar fletëthirrjen palës së dëmtuar Ajdin Mushoviqit dhe dëshmitarit Bujar Mushoviq. Fletëthirrje u lëshua edhe për dëshmitarin Naser Mushoviq. Kur u zbulua se kjo nuk mund të dorëzohej me postë normale policisë iu lëshua një urdhëresë, për të kërkuar dëshmitarin dhe në rast se gjendet ti dorëzohej fletëthirrja personalisht.

Me datë 10 Janar 2011, ditën kurë lënda ishte caktuar për gjykim, Policia e Kosovës parashtrroi raport me shkrim ku thuhej se Naser Mushoviq nuk mund të gjendej. Mu atë ditë na u kthye një raport nga autoritetet e Malit të Zi përmes divizionit për ndihmë ligjore ndërkombëtare të Ministrisë së Drejtësisë se Malazet nuk mundën të gjenin Mushoviqet.

Me datë 10 Janar 2011 gjykimi filloi pas marrjes së raportit nga policia dhe njoftimit nga Ministria e Drejtësisë lidhur me përgjigjen nga autoritetet Malazeze.

Me datë 11 Janar 2011 u dëgjuan fjalët përfundimtare dhe u shpall aktgjykimi. Prokuroria në fjalën e saj përfundimtare ftoi gjykatën që të liroj të pandehurin, siç bëri edhe mbrojtja.

B. KOMPETENCAT E GJYKATËS

Ligji i aplikueshëm, Kompetenca dhe Përbërja e Panelit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Aktakuza është parashtruar me datë 23 Nëntor 2000. Sipas Nenit 550 të KP-së, procesi gjyqësor penal i shkalles së parë ku u parashtrua aktakuza para se të hynte në fuqi KPPPK-ja (6 Prill 2004), e që nuk ishte kompletuar deri me këtë datë, do të vazhdoj sipas dispozitave të ligjit paraparak të aplikueshme, Ligjit mbi Procedurat Penale 1986 (LCP).

Sipas Nenit 23, paragrafi 1 të LPP-së lidhur me Nenin 29 paragrafi 2 nën paragrafi 1 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të viti 1978, Gjykatat e Qarkut do të kenë kompetenca për të gjykuar, në shkallen e parë, veprat penale të dënueshme me burgim më shumë se pesë vite.

Në lenden aktuale i akuzuari akuzohet për Vrasje në kundërshtim me nenin 30(3) të LPK-së, kjo vepër penale është brenda kompetencave të Gjykatës së Qarkut.

Vepra penale, sipas aktakuzës, është kryer në Gjakovë dhe kështu lënda bie nën kompetencë territoriale të Gjykatës së Qarkut të Pejës.

Lënda në fjalë është caktuar në kompetencë të Gjyqtarëve të EULEX-it përmes vendimit të Kryetares së Asamblesë së gjyqtareve të EULEX-it lëshuar me datë 21 Janar 2010, në pajtim me nenin 3.3 dhe 3.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjes dhe Caktimit të Lëndëve Gjyqtareve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Seanca Kryesore

Shqyrtimi kryesor ishte publik dhe u mbajt brenda godinës së Gjykatës së Qarkut në Pejë me datë 10 dhe 11 Janar 2011 në prani të Prokurorit Publik, të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës.

Në përputhshmëri me Nenin 7 të LPP-së, përkthyes ndërkombëtar përkthyen procesin gjyqësor si dhe të gjitha dokumentet relevante të gjykimit, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe si dhe anasjelltas, sipas nevojës. Në fillim të seancës së datës 10 Janar 2011 ishte i pranishëm një përkthyes për gjuhën serbe. Megjithatë ajo u lirua pasi që kryetari i trupit gjykues konstatoj në gjykatë të hapur se askush nga të pranishmit aty nuk kishte nevojë për shërbimin e saj.

B. PËRMBLEDHJA E DËSHMIVE TË PARAQITURA

Gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor, i pandehuri dhe dëshmitarët në vijim janë dëgjuar:

Bekrije Vosha (gruaja e tanishme e të pandehurit).

Deklarata, raporte policore si dhe dëshmi të tjera të dokumentuara janë lexuar gjatë gjykimit.

a) Dëshmi të dokumentuara dhe raporte

Gjatë shqyrtimit kryesor, këto dokumente janë lexuar si dëshmi, në pajtim me Nenin 332 të LPP-së.

- i) Raport policor i KFOR-it i datës 29.06.00 nga Eros Luciano Sto.
- ii) Fotografitë e të ndjerit bashkangjitur raportit të cekur më lart.
- iii) Raport i shkruar nga Dr Maurizio Tommaselli i datës 11.08.00.
- iv) Raport policor i KFOR-it i datës 11.08.00 nga Eros Luciano Sto.

b) Deklarata

Gjatë shqyrtimit kryesor deklaratat në vazhdim janë lexuar me zë si dëshmi, duke zëvendësuar dëgjimin e drejtpërdrejt të dëshmitarëve, në bazë të pajtimit të palëve (shih procesverbalin e seancës së mbajtur me 10 Janar 2010) në pajtim me Nenin 333, paragrafi 2 të LPP-së:

- i) Bekrije Bosha e marr me datë 08.08.00
- ii) Ramadan Jetishi e marr me datë 06.09.00
- iii) Sadik Koci e marr me datë 6.9.00
- iv) Sahar Shkodra e marr me datë 6.9.00
- v) Selajdin Rugova e marr me datë 13.9.00
- vi) Bujar Mushoviq e marr me datë 28.9.00
- vii) Ajdin Mushoviq e marr me datë 28.9.00
- viii) Alta Mushoviq e marr me datë 28.9.00
- ix) Nexhmije Zena e marr me datë 17.10.00

Deponimet e dëshmitarëve në vazhdim të dhëna në gjykimin e parë në vitin 2001 janë lexuar po ashtu sipas nenit 333, paragrafi 2 të LCP me pajtimin e palëve (shih procesverbalin e seancës së mbajtur me datë 10 Janar 2010):

- i) Ramadan Jetishi
- ii) Bekrije Bosha
- iii) Selajdin Rugova
- iv) Sajar Sjkodra
- v) Nexhimie Zena
- vi) Ardita Kelemendi
- vii) Vjollca Zena
- viii) Sanije Lluhani
- ix) Ilirjana Lluhani
- x) Sto Eros Luciano

C. MUNGESA E PALËS SË DËMTUAR

Mungesa e palës së dëmtuar ka penguar rigjykimin e kësaj lënde së paku që nga dështimi i rigjykimit të vitit 2004. Gjykata ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të gjetur palën e dëmtuar apo ndonjë pjesëtar të familjes së tij; të gjitha këto përpjekje ishin të pa suksesshme. Gjykimi filloi vetëm atëherë kur të gjitha linjat e arsyeshme të hetimit u përdoren. Në veçanti gjykata nuk pati mundësi të gjej asnjë nga palët e dëmtuara- pjesëtar të familjes Mushoviq – përmes divizionit për ndihme ligjore ndërkombëtare të Ministrisë së Drejtësisë e cila ka ndërlidhje me autoritetet Malazeze apo përmes UNHCR-it të cilët ishin në kontakt me familjen Mushoviq para ca viteve. Prandaj mundësia e vetme ishte të lexohen deklaratat e mëparshme e palëve të dëmtuara.

D. RIKONSTRUKTIMI I NGJARJEVE FAKTIKE

Deri në ditën kritike i pandehuri Agim Sylejmani, një shqiptar i Kosovës, dhe së voni i ndjeri Berat Mushoviq i kombësisë Boshnjake, ishin fqinjë në Gjakovë.

Para luftës familja e të pandehurit si dhe familja Musheviq jetuan në raporte miqësore si fqinjë përkundër dallimit të tyre etnik.

Pas luftës i akuzuari në disa raste kërcënoi anëtarët e familjes Musheviq. Kjo i parapriu ngjarjes së orëve të pasdites në dite kritike, para se të ndodhnin të shtënat, se Berat Musheviq gjersa po kalonte me biçikletë e ndali të akuzuarin në rrugë aty filloj fjalosja verbale, e cila eskaloj dhe Berat Musheviq u morë me të akuzuarin duke i ra së paku njëherë në fytyrë. I akuzuari vazhdoi për në shtëpi, pastroj fytyrën dhe njoftoj gruan e tij se do të shkonte në shtëpinë e familjes Mushoviq për të folur me babanë e Beratit. I akuzuari doli nga shtëpia e tij me kaminonetën e bardhë e cila ishte e punëdhënësit të tij, një OJQ-je Suedeze dhe për në shkoi te shtëpi të familjes Musheviq. Pyetja, nëse i biri i tij Ilir, i cili atëbotë ishte 17 vjeç, a e shoqëroi të atin në kamionet gjersa shkoi tek shtëpia e Musheviqeve, ishte e paqartë për trupin gjykues të shqyrtimit kryesor që u morë në me këtë lëndë në vitin 2001 dhe ngeli e pazgjidhur edhe për trupin gjykues në rigjykim. Menjëherë pasi që i akuzuari arriti para dyerve të shtëpisë së Musheviqeve, rruga “Mark

Malota” Nr. 15 Berat Musheviqi u afrua te dera e hyrjes duke mbajtur pistoletën “Tocarev”, e cila ishte e mbushur me së paku katër fishek. Gjykata – e shqyrtimit të parë gjyqësor në vitin 2001 si dhe e rigjykitimit nuk mundi të jetë e sigurtën ese ishte edhe i akuzuari i armatosur. Trupit gjykues iu deshtë ta linte të pazgjidhur pyetjen se a ishte i akuzuari i armatosur me armë automatike AK 47, edhe pse është treguar qartë se i akuzuari ishte i pranishëm kur Berat Musheviq u qëllua për vdekje në kokë me një plumb të AK 47 në fjalë, e cila ishte e familjes së Agim Sylejmanit. Trupi gjykues nuk mund të përjashtoj mundësin se Ilir Sylejmani mori AK 47, pa pëlqimin e të pandehurit, nga shtëpia e tyre, shkoj vetë në shtëpinë e Musheviqeve dhe përdori mitralozin pasi që Berat Musheviqi hapi zjarr duke shtënë nga pistoleta e tij. Përtej gjithë dyshimeve të mundshme Berat shtiu nga pistoleta e tij dy herë. Së paku është më se e mundshme që ishte Berati i cili shtiu i pari, sepse do të ishte jashtë reales që ai vetëm u përgjigj të shtënave që iu drejtuan atij pasi të ketë qenë qëlluar me plumba të mitralozit në kokë nga të cilat ai shpejtë vdiq. Gjykata nuk ka mundësi të tregoj kohën e saktë se kur vdiq Berati, por se nuk ka dyshim që një plumb i mitralozit e qëlloi dhe dëmtoi trurin e tij rëndë, si pasoj e kësaj ai tashmë kishte vdekur si rezultat i plagës në kokë, kur mjeket në spital u munduan ti jepni ndihmën e parë mjekësore. Trupi gjykues ka mjaft përvojë nga procedura të ngjashme për të vlerësuar se i ndjeri Berat duke pasur një lëndim të tillë vdekjeprurës nuk do të ishte në gjendje të shtënte dy herë nga revolja e tij pasi të ketë qenë i qëlluar në kokë. Sido që të jetë duket të jetë e mundshme për trupin gjykues që Berati hapi zjarr me një të shtënë nga pistoleta e tij, e shtëna e tij u kthye me disa të shtëna dhe njëra nga to e qëllloi atë në kokë, dhe pas kësaj të shtëne vdekjeprurëse, Berati shtiu për të dytën herë, para se të vdiste, dhe me sa duket qëllloi këmbën e vetë.

Ilir Sylejmani ia mbathi pas kësaj ngjarjeje nga vendi i ngjarjes dhe akoma nuk është gjetur. Arma AK 47 nga e cila u qëllua Berat Musheviq u konfiskua gjatë bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit i cili vullnetarisht shkoi në polici kur kuptoj se po kërkohet. Arma u ekzaminua dhe është jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo armë ishte arma nga e cila u shkrep e shtëna fatale. Afër vendit ku Berati u qëllua për vdekje dhe ra në tokë brenda shtëpisë afër hyrjes, oficeri policor Italian Eros Luciano, i cili inspektoj vendin e ngjarjes, gjeti dy gëzhoja të spërkatura me gjakun e Beratit dhe ndjeu erë baroti. Që të dy ishin të kalibrit 7,65 mm dhe ishin shkrepur nga pistoleta “Tocarev”. Herët në mëngjes pas

ngjarjes kur anëtarët e familjes Musheviq tashmë kishin pastruar gjakun e Beratit – ishte një pellg gjaku në dhomën e lavanderis – i vëllai Beratit, Bujari dorëzoi pistoletën të mbështjell me një peshqir me njolla gjaku te komandanti i policisë Eros Luciano pas kërkesës së tij që të ja jepte mu atë armë e cila ishte përdorur gjatë natës së mbrëmshme brenda shtëpisë së Mushoviqeve. Në pistoletë ishin dy plumba, një në karikator dhe një në tytë.

Që të dy armët e konfiskuara, the Kalashnikovi dhe Tocarev, janë dorëzuar në besim te KFOR-i nga UNMIK-u, dhe janë shkatërruar nga njësitë special të KFOR-it në Korrik të vitit 2000.

E. VLERËSIMI I DËSHMIVE TË PARAQITURA

1.) Nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të gjetur të akuzuarin si fajtor për krimin e akuzuar. Ai akuzohet për veprën penale se ka vra me qëllim Berat Musheviqin në bashkëkryerje me të birin e tij Ilirin.

Sipas Nenit 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1976 (KPRSFJ) – Bashkëfajësia - një vrasje e kryer së bashku është një parakusht për të gjetur të akuzuarin fajtor. Ka ngel e pavërtetuar se i akuzuari vetë ka shtënë në Berat Mushevicin apo se dikush tjetër, në veçanti biri i tij Iliri shtiu në të me pëlqimin paraprak të të akuzuarit.

a) I akuzuari vetë mohoj çfarëdo përgjegjësie lidhur me të shtënat në Beratin dhe deklaroi se ai nuk kishte përdorur vetë armen e as nuk kishte planifikuar dhe/apo pajtuar për të shtënë në Beratin djali i tij apo dikush tjetër.

Trupi gjykues është i vetëdijshme për faktin se hyrja e shfajësimit në akuzë kur i akuzuari mohon ta ketë kryer krimin mundet vetëm të shihet si një tregues i vogël i pafajësisë së tij, sepse i akuzuari ka të drejtë të gënjej. Shfajësimi nuk u bazua thjeshtë në deklaratën e të akuzuarit. Në vendimin e trupit gjykues vendimtare ishte mungesa e dëshmive të mjaftueshme për dënim.

b) Deklarata e të akuzuarit mbështetet nga deponimi i gruas së tij e cila vërtetohet tashmë gjatë fazës paraprake të gjykimit se burri i saj doli nga shtëpia i paarmatosur e cila dha dëshmi në gjykatë gjatë këtij rigjykimi se i akuzuari doli nga shtëpia e tyre ditën kritike vetëm dhe se praktikisht nuk ishte i shoqëruar nga biri i tij Iliri kur shkoj tek shtëpia e Musheviqeve.

Gjykata e di nga shume procedura të tjera gjyqësore se të afërmit në gjykim si rregull janë të prirë të japin dëshmi në favor të të akuzuarit i cili është anëtar i afërt i familjes si në këtë rast gruaja e Agim Sylejmani. Si do që të jetë ky argument zbatohet në mënyrë të barabartë me deklaratat e dhëna nga palët e dëmtuara të cilat në përgjithësi kanë tendencën që të dëshmojnë në favor të viktimës dhe në dëm të të akuzuarit.

c) Vetë palët e dëmtuara nuk mundën të intervistoheshin nga gjykata sepse të gjitha përpjekjet për ti gjetur dhe ftuar dështuan. Me sa duket e tërë familja Mushoviq ka lëshuar Kosovën dhe tani jetojnë në një vend të panjohur. Edhe po të ishte e mundur të intervistoheshin ata gjatë këtij shqyrtimi kryesor, një dëshmitar nuk do të mundte të jep dëshmi të forta pas 10 viteve të intervistimit nga gjykata për të njëjtën ngjarje se sa të paren herë kur është intervistuar.

Për të gjetur të vetveten dhe për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e palëve të dëmtuara trupi gjykues vendosi mbi marrëveshjen e të gjitha palëve të pranishme të lexoj me zë deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar në fazat më të hershme të këtyre proceseve gjyqësore, duke përfshirë edhe palët e dëmtuara. Por vlerësimi i të gjitha këtyre deponimeve shpie në përfundimin e njëjtë të nga ky trup gjykues: Dëshmitë janë të pamjaftueshme për të gjetur të akuzuarin fajtor.

Dënimi i të akuzuarit për vrasjen e Berat Musheviq nuk mund të bazohet në deklaratat e palëve të dëmtuara Alta Musheviq, nënës së viktimës, Ajdin Musheviq, babait të viktimës dhe Bujar Musheviq, njërit nga vëllezërit e tij. Ata janë intervistuar dhe kanë dhënë deklaratat të cilat nuk janë të qëndrueshme. Të tre dëshmitarët kanë dëshmuar se i akuzuari ishte i shoqëruar nga dy djemtë e tij Ilirin dhe Adonisin dhe secili nga ta ishte i

armatosur me Kalashnikov. Përveç faktit se nuk ka tregues apo gjurmë se më shumë se një Kalashnikov ishte në vendin e ngjarjes, është treguar se Adonis Sylejmani, djali më i madh i të akuzuarit nuk kishte dorë në këtë punë. Sipas alibisë së vërtetuar të tij Adonisi është i pafajshëm.. Ne kohën e krimit Adonisi ishte në Prishtinë duke punuar në një kompani. Ky fakt është vërtetuar menjëherë nga policia pas të shtënave dhe nuk ka asnjë dyshim.

Trupi gjykues gjeti arsye të tjera se perse dëshmitë e palëve të dëmtuara janë të pabesueshme.

- Alta Musheviq në mënyrë kategorike përjashtojnë çfarëdo gjuajtje nga brendësia e shtëpisë së tyre kur deklaroi se asnjëri prej tyre shtiu mbi sulmuesit. Është vërtetuar mirë se Berat Musheviq shtiu nga brendësia e shtëpisë së tij dy herë nga pistoleta "Tocarev".
- Deklarata e Ajdin Musheviq, babai i Beratit, së paku ishte çorientuese kur deklaroi se i akuzuari dhe dy djemtë e tij të gjithë ishin të armatosur me armë automatike, sepse në fund të deponimit të tij, të dhënë në seancën e datës 28. 09. 2000 para gjyqtarit hetues, ai pohoi të ketë parë një armë automatike në veturën e Agimit.
- Po ashtu përshkrimi i Bujar Musheciqit për ngjarjen nuk është bindës. Ai deklaroi, në seancën e përmendur më parë, se kishte pa të akuzuarin dhe dy djemtë e tij secili i armatosur me Kalashnikov, kishte dëgjuar rafale të shtënash nga të tri armët automatike dhe ka pa të tri të shtënat në drejtim të derës, ku u shfaq vëllai i tij Berati, dhe pa ta kenë qëlluan për tokë Beratin. Pastaj Bujari pohoi se ka pa të akuzuarin, akoma të armatosur me Kalashnikov hyri në oborr duke bërëtitur se kishte ardhur aty për të vra të gjithë i akuzuari i është afruar Bujarit dhe Naser Musheviqit, i cili mbeti pak më prapa Bujarit, por se ishte vetëm rreth 7 metra larg nga i akuzuari, dhe kur ai, Bujari, u afrua ai më tej nuk e pa armen në duart e të akuzuarit; i akuzuari atëherë e kapi për qafe, Bujarin, dhe filloi ta rrihte atë. Bujari ia ktheu dhe Ramadan Jetishi i ndau ata. Së fundi i akuzuari u largua pasi që

u dëgjua britma nga shtëpia; të bijtë e të akuzuarit tashmë veç ishin larguar nga vendi i ngjarjes.

Përshkrimi i Bujarit nuk ka logjikë, sepse duket e pamundshme që dëshmitari nuk pati mundësi të vërente nga ajo largësi aq e vogël se çka ndodhi me armen e Agimit dhe pse i akuzuari vazhdoi sulmin e tij papritmas pa armë dhe pse të bijtë e tij të armatosur ishin zhdukur aty për aty.

Dëshmitari tjetër i familjes Mushevic, Naser Musheviq, nipi i Ajdin Musheviqit, nuk ka mundur të ftohej për shqyrtimin kryesor të vitit 2001 po për fazën paraprake gjyqësore dhe kështu asnjëherë nuk është dëgjuar. Po ashtu as ky trup gjykues nuk mundi ta ftoj atë. Nuk ka tregues të njohur lidhur me vendndodhjen e tij.

d) Asnjë nga dëshmitarët tjerë të cilët kanë dhënë dëshmi gjatë procedurës janë të përshtatshëm për të treguar fajësinë e të akuzuarit. Dyshimet që mbizotërojnë lidhur me këtë mbesin madje edhe pas vlerësimit të deklaratave të të gjithë dëshmitarëve.

Kjo në veçanti ka të beje me dëshminë e dëshmitarit Eros Luciano, komandantit të njësitit hetues të UNMIK-ut. Trupi gjykues shprehimisht ndanë vlerësimin e trupit gjykues të shqyrtimit të parë gjyqësor se ky dëshmitar është i besueshëm dhe deklarata e tij është konsekuente, e saktë, e paanshme dhe në tërësi bindëse.

Sipas konkludimeve të Eros Luciano, i cili kreu hetimet policore, mbeti e paqartë për të, nëse i akuzuari shkoi i paarmatosur në shtëpinë e Musheviqeve dhe si rezultat i kësaj të mos ketë shtënë.

Si u sqarua më herët edhe për këtë trup gjykues mbetet e pavërtetuar se i akuzuari vetë ka shtënë në Berat Musheviq. Përkundër kësaj paqartësie i akuzuari mund të gjendej fajtor për vrasje po të ishte bashkëfajtor apo së paku nxitës i dorasit, me shumë mundësi të djalit të tij Ilirit.

Parakusht i një pretendimi të tillë është një marrëveshje me dorasin e veletet para gjuajtjes.

Lidhur me këtë dëshmitari Eros Luciano dëshmoj se i akuzuari i kishte thënë atij se e kishte pa në vendin e ngjarjes, ose para ose pas gjuajtjes djalin e tij Ilirin të armatosur me

Kalashnikov. Iliri i kishte shkuar prapa atij kur ai shkoi vetëm në shtëpinë e Musheviqeve.

Po të kishte shkuar i akuzuari me djalin e tij Ilirin së bashku nga shtëpia e tij tek shtëpia e Musheviqeve dhe njeri nga ta ishte i armatosur me Kalashnikov, kjo do të ishte provë e fort në dëm të të akuzuarit. Po ashtu p të kishte pa i akuzuari djalin e tij të armatosur me Kallashnikov para se kjo armë të shkrepëj, kjo do shihej si tregues i fortë e një marrëveshje paraprake e të akuzuarit për të shtënat.

Sipas dëshmisë së dëshmitarit Eros Luciano është po ashtu e mundshme që i akuzuari ka pa të birin Ilirin pas të shtënave dhe e ka pyetur atë: "pse e bëre këtë?"

Kjo mundësi e cila nuk mund të përjashtohet është një tregues i fort se i akuzuari nuk ishte i përfshirë ne çfarëdo marrëveshje paraprake për të shtënat para kësaj. Ne veçanti, nëse ai e ka pyetur djalin e tij Ilirin, se pse e beri këtë, me fjalë të tjera pse kishte shtënë, ai nuk do të kishte pasur njohur për një gjuajtje të planifikuar dhe nuk ka mundur të jetë pajtuar për këtë paraprakisht.

Për këtë arsye trupi gjykues nuk gjeti arsye të mjaftueshme për të pranuar rastin në Bashkëkryerje (Neni 22 KPRSFJ). Dhe për arsye të njëjta ka mungesë provash po ashtu edhe lidhur me Ndhmën (Neni 24 KPRSFJ).

Deponimet e dëshmitarëve tjerë ishin jothelbësor dhe nuk kishin të bënin me piken kryesore që do të thotë me dëshminë për fajesinë e të akuzuarit.

Përpos mungesës së provave lidhur me çështjen e bashkë-Kryerjes trupi gjykues me asnjë mënyrë nuk mund të përjashtoj mundësinë se i akuzuari veproj në vetëmbrojtje me pasoj që veprimi i tij- për shkak të nevojës ekstreme, Neni 10 KPRSFJ)– nuk mund te merret si vepër penale.

Bazuar në deklaratën e besueshme të dëshmitarit Eros Luciano dy të shtëna nga pistoletë ishin shkrepur nga brendia e shtëpisë. Kjo nuk mund të kontestohet sepse oficeri policor gjeti dy gëzhoja të pistoletës Tocarev tek vendi ku i ndjeri Berat Mushevic ra për tokë. Duhet te merret si fakt se Berati shtiu dy herë, te paktën një herë para se të vdiste dhe ka shume gjasa që herën e dytë deri sa po vdiste. Madje edhe vëllai i tij, Bujar Musheviq i

sqaroi oficerit policor Lugiano, se Berati kishte përdorur “Tocarev” ditën kritike dhe kjo është e nënkuptueshme se ai nuk ka mund të shtinte pasi që ka vdekur.

F. Vlerësimi ligjor

Trupi gjykues përdorur të gjitha provat e siguruar, por përkundër kësaj mbeten prova të pamjaftueshme për të denuar të akuzuarin. Si rezultat i kësaj dhe sipas parimit “in dubeo pro reo” ishte detyrë e trupit gjykues që të liroj të akuzuarin.

G. SHPENZIMET

Sipas Nenit 99 par 1 të LPP-së, shpenzimet e këtij procesi gjyqësor si dhe shpenzimet e domosdoshme të të akuzuarit do të mbulohen nga buxheti i gjykatës.

Sot, me datë, 11 Janar 2011.

P no 141/01

E përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë zyrtare

Procesmbajtësja Ndërkombëtare

Robina Struthers

Kryetar Ndërkombëtar i Trupit Gjyqësor

Ingo Risch

Anëtarë i Trupit Gjyqësor/ Gjyqtari Ndërkombëtar

Gunnar Oyhaugen



Anëtare e Trupit Gjyqësor/ Gjyqtarja Vendore

Lumturije Muhaxheri

Këshillë juridike

Personat e autorizuar mund të parashetrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykates ë Qarkut në Pejë për Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes së këtij aktgjykimi.

Përkthej: Sh. TURJAKA

EULEX0420L